



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



01 Nr. 020 - 7110 dt. 06/02 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.12-030-13300 të datës 07.03.2018, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V e n d i m

Për caktimin e Koordinatorit dhe Anëtarëve për menaxhimin e rrezikut dhe zbatimin e Planit të integritetit të Komunës së Drenasit.

- I. Koordinator për menaxhimin e rrezikut dhe zbatimin e Planit të integritetit të Komunës së Drenasit, emërohet z. Shaban Dobra (Koordinator), znj. Luljeta Nebihu (Anëtar) dhe z. Fadil Tahiri (Anëtar).
- II. I lartpërmenduri ka për detyrë që të përcjell realizimin e aktiviteteve për menaxhimin e rrezikut dhe për zbatimin e Planit të integritetit 2018-2020 të Komunës së Drenasit të aprovuar me datën 07.03.2018, me Nr.12-030-13300.
- III. Për aktivitetet e ndërmarra nga të gjitha Drejtorit dhe Sektorët e Komunës për zbatimin e Planit të integritetit, Koordinatori dhe Anëtarët duhet të raportojnë në formë të shkruar në periudha tremujore, duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2018 e tutje.
- IV. Forma e raportimit me shkrim i dërgohet Kryetarit të Komunës më së largu 15 ditë pas kalimit të periudhës raportuese.

- V. Obligohen të gjitha drejtoritë/ sektorët që të bashkëpunojnë me koordinatorin dhe anëtarët për të ofruar të gjitha të dhënat dhe dokumentet që kanë të bëjnë me zbatimin e Planit të integritetit.
- VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendim shfuqizohet Vendimi Nr. 01-112-36824, i datës 01.07.2019.
- VII. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të komunës.



Kryetari i Komunës
[Signature]
Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Koordinatorit dhe Anëtarëve;
- Të gjitha Drejtorive Komunale;
- Arkivit të komunës së Drenasit.